



Statuti i shoqatës

Përmbajtja

1.	Emri i shoqatës	2
2.	Selia dhe viti i shoqatës	2
3.	Detyrat dhe qëllimet e shoqatës	2
4.	Anëtarësia	3
5.	Përfundimi i anetarësisë	4
6.	Organet e Shoqatës	4
7.	Tubimi i Shoqatës	4
8.	Kryesia e Shoqatës	5
9.	Arkatari	5
10.	Fuqizimi	5

1. Emri i shoqatës

- 1.1. Emri i shoqatës është "TASH - Platformë gjermano-shqiptare".
- 1.2. Shoqata të mbajë akronimin TASH".

2. Selia dhe viti i shoqatës

2.1. Shoqata e ka selinë në Eppingen. Ajo do të regjistrohet pranë Gjykatës Komonale në Heilbronn dhe pas regjistrimit do t'i bart mbrapashtesat e.V. – Shoqatë e regjistruar.

2.2. Viti i shoqatës është njëkohësisht vit kalendarik.

3 Detyrat dhe qëllimet e shoqatës

3.1 Shoqata është një Iniciativë cila pretendon te njoh me njeri-tjetrin qytetaret gjermanë dhe shqiptarë në Gjermani, që sipas nevojave të tyre, të krijojë një shkëmbim me të mire ne fusha ty ndryshme dhe te zhvilloin projekte.

3.2 Qëllimi i shoqatës është që të promovojë qëndrimin ndërkombëtarë, tolerancën në të gjitha fushat e kulturës dhe mirëkuptimit ndërkombëtarë, promovimin e edukimit dhe promovimit të mirëqenies të rinjve. Qëllimi i Statutit dote arritet në mënyrë të veçantë nga aktivitetet:

Me anë të veprimtarive këshilltare:

- (a) Ku një qytetari te interesua ose një anëtar te ri te shoqatës, i qëndron afër me këshilla dhe informata.
- (b) Ku atij/asaj i ndërmjetësohen persona ose organizata me cillen kemi bashkpunim si p.sh. të DAAD, Goethe-Institut etj.
- (c) Ku mund të përfshihent pyetje të veçanta ose dëshira dhe aq sa është e mundshme, të kërkohet një zgjidhje.

Me anë të veprimtarive aktive:

Me anë të mbrëmjeve kulturore, të cilat do të organizohen:

- (a) Ku në to personazhe të shoqërisë gjermane dhe shqiptare diskutojnë mbi tema speciale me qytetar te interesuar.
- (b) Ku në to muzikantët dhe artistët mund të prezantojnë veten dhe veprat e tyre.
- (c) Ku në to diskutohet përmbi tema politike, sociale ose kulturore.
- (d) në të cillen dotë informohet rrëth projekteve botëror të kembimit dhe shoqata dote ketë per qëllim të realizoi një projekt të vet te kembimit.

- 3.3 Pikësynimet e kësaj platformë shtrihen në rrafshin edukativ, në luftimin e varfërisë, për demokraci, për të drejtat e njeriut dhe për të drejtat sociale. Kjo duhet sidomos të arrihet përmes mundimeve, që qytetarëve të interesuar, t'iu jepet mundësia ta mbajnë një praktikë, seminar ose ligjeratë (si mysafirë) në vendet që përkatës që të paraqiten pikat e përmendura më lartë, për sensibilizim ose që këto pika të jetësohen në formë të projekteve.
- 3.4 Prej qytetarëve të interesuar gjermanë dhe shqiptarë, kërkohet përkrahje dhe angazhim me qëllimin parësor që, si në mënyrë materiale poashtu edhe në atë organizative të ndihmohet në fusha të ndryshme vecanërisht në fushën e Edukimit me bursa, menotrim edhe keshillim.
- 3.5 Në mënyrë materiale si dhe me anë të ideve të ndihmohet avancimi i arsimit, edukimit dhe përkujdesja për të rinjtë. Të krijohet mundësia e ofrimit të mjetëve shtesë si për kuadrot gjithashtu edhe për mjetet e mësimi, të ofrohet ndihmë në organizimet shkollore të çfarëdo mënyre si dhe në inventarin shkollor në të dy vendet, sipas mundësive dhe buxhetit.
- 3.6 Të ndihmohet kooperimi midis univerziteteve gjermane dhe shkollave të larta shqipfolëse në mënyrë organizative, financiare dhe kadrovike në harmoni me mundësitë e shoqatës.
- 3.7 Kjo shoqatë ndjek vetëm e vetëm dhe drejtpërdrejtë synime (qëllime) të dobishme, sipas kuptimit të fragmentit të dhënë nga rregullorja "për qëllime favorizuese taksore (tatimi).
- 3.8 Veprimtaria e shoqatës është vetmohuese (altruiste); Ajo nuk ndjek në radhë të parë qëllimet e veta ekonomike.
- 3.9 Mjetet e shoqatës mund të përdoren vetëm për qëllime të përmendura në statut. Anëtarët nuk marrin asnjë shpërblim nga mjetet e shoqatës.
- 3.10 Asnjë person nuk guxon të shpenzojë mjete për qëllime tjera që nuk janë të menduara në program, ose të pasurohen me një shpërblim tejmase.
- 3.11 Në rast shpërbërjeje të shoqatës ose rënije/anulimi të qëllimeve bamirëse të shoqatës mjetet e shoqatës i takojnë organizatës Fshatrat e Fëmijëve SOS, Ridlerstraße 55, 80339 München, e cila duhet t'i përdorë direkt dhe ekskluzivisht për qëllime bamirëse dashamirëse apo fetare. Kjo duhet t'i përdorë fondet ekskluzivisht për shtëpitë e fëmijëve në botën shqipfolëse, sidomos për fshatrat e fëmijëve në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.
- 3.12 Shoqata është fetarisht, ideologjikisht dhe politikisht neutrale.

4 Anëtarësia

- 4.1 Anëtar mund të bëhet çdo person i rritur i cili perkohet qëllimet bamirëse të shoqatës.
- 4.2 Pranimi në shoqatë bëhet nga kryesia, në bazë të nënshkrimit të dokumentit pranues. Akti i dorëzimit të dokumentit pranues nga nënshkruesi (kërkuesi i cili dëshiron të pranohet në shoqatë) vërteton njohjen e rregullores (statutit) së shoqatës.
- 4.3 Shoqata kërkon një pagesë të anëtarësisë. Tarifa e anëtarësisë përcaktohet nga mbledhja e anëtarëve.
- 4.4 Çdo anëtar ka të drejtën e shprehjes së mendimit të lirë dhe konstruktiv mbi qëllimet e shoqatës.

5 Përfundimi i anëtarësisë

- 5.1. Anëtarësia në Iniciativën Studentore gjermano-shqiptare TASH në Reutlingen përfundon:
 - (a) nëse anëtari largohet nga Shoqata
 - (b) nëse anëtari detyrohet të largohet, nëse këtë gjë e vendos Kryesia e Shoqatës
 - (c) me vdekjen e anëtarit
- 5.2. Largimi mund të bëhet në çdo kohë përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim në kryesi.
- 5.3. Largimi i detyrueshëm i anëtarit bëhet në mbledhje të rëndomtë apo të veçantë të anëtarësisë. Vendimi i marrë në këtë mbledhje duhet t'i dërgohet me shkrim anëtarit të larguar.
- 5.4. Ankesat e anëtarit të larguar kundër vendimit për largim duhet të prezentohen në mbledhjen e ardhshme të anëtarësisë.
- 5.5. Edhe kryesisë i ofrohet mundësia e largimit me detyrim të një anëtari.
- 5.6. Pas shlyerjes nga anëtarësimi, anëtari humb çdo të drejtë ndaj shoqatës dhe pasurisë së saj.
- 5.7. Përgjegjësia e shoqatës ndaj personit të tretë është e arsyetuar në § 31 BGB dhe në rregullat e përgjithshme ligjore (§ 823 BGB).
- 5.8. Kryesia duhet të japë përgjegjësi për veprimet e bëra me qëllim në dëm të shoqatës si dhe ato fare të pamenduara. Shoqata jep vetëm atëherë përgjegjësi për kryesinë nëse këta (kryesia) kanë vepruar si kryesi për shoqatën dhe kanë punuar në interes të shoqatës.

6 Organet e Shoqatës

- 6.1 Organet e shoqatës janë mbledhja e anëtarëve dhe kryesia.

7 Tubimi i Shoqatës

- 7.1. Të gjitha tubimet thirren përmes Kryesisë. Kryesia duhet ta bëjë këtë me shkrim, të paktën 10 ditë para datës së tubimit.
- 7.2. Mbledhja e anëtarësisë bëhet një herë në vit dhe udhëhiqet prej kryetarit ose zëvendësit të tij.
- 7.3. Mbi mbajtjen e një mbledhjeje të veçantë të anëtarësisë vendos kryesia e asaj iniciative, nëse posedojnë përkrahjen e një të tretës së anëtarëve.
- 7.4. Procesverbalet e tubimeve vendosen në arkivin e shoqatës.
- 7.5. Kryesia e shoqatës, në mbledhjen e anëtarësisë, është e detyruar t'i njoftoj anëtarët mbi punën që bën shoqata.
- 7.6. Mbledhja e anëtarësisë mund të mbahen në të gjitha qytetet në Gjermani. Kjo lajmërohet me kohë nga kryesia.
- 7.7. Mbledhjet e kryesisë do të thirren dhe drejtohen prej kryetarit apo në mosprani të tij, prej zëvendësit.
- 7.8. Vendimet e kryesisë dhe të shoqatës bëhen të plotfuqishme nëse dy të tretat e anëtarëve i pranojnë këto vendime.
- 7.9. Mbledhja e anëtarësisë vendos mbi:
 - (a) Zgjedhjen dhe angazhimin e anëtarëve të rinjë në kryesi
 - (b) Përcaktimin, punën që duhet ta bëjnë Komisionet dhe fuqizimi i tyre apo i ndonjë anëtari të veçantë ta bëjë këtë punë
 - (c) Ndryshimin e statutit të shoqatës

Statuti i shoqatës "TASH –Platformë gjermano-shqiptare" e.V.

(d) Shpërndarjen e shoqatës

(e) Pranimin e përmbledhjes vjetore të punëve të shoqatës me shkrim dhe lejimin e llogarisë vjetore

(f) dhe punë tjera.

8 Kryesia e Shoqatës

- 8.1. Kryesia e Platformes gjermano-shqiptare TASH në Eppingen, zgjedhet çdo vit sërish prej anëtarëve të saj, me mundësinë e zgjedhjes së sërishme për një vit.
- 8.2. Kryesia e shoqatës është legjitime të përfaqësojë atë (shoqatën) në harmoni me § 26 BGB. Ajo përbëhet prej kryetarit, zëvendësit të tij dhe arkatarit. Shoqata përfaqësohet nga dy përfaqësuesit e autorizuar së bashku.
- 8.3. Kandidati i cili pretendon të kandidojë për kryetar të shoqatës duhet të posedojë së paku një anëtarësi gjashtëmujore në shoqatë.
- 8.4. Kryesia apo anëtari i kryesisë mundën në çdo kohë me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm të shoqatës, të largohen nga posti i tyre.
- 8.5. Nëse largohet ndonjë anëtar i kryesisë para kohe nga detyra e tij, atëherë kryesia ka të drejtë të emërojë një anëtar të ri, deri në mbledhjen e anëtarësisë.
- 8.6. Anëtarët e zgjedhur të kryesisë drejtojnë punët e shoqatës.
- 8.7. Mbi çështjet e rëndësishme, parasëgjithash mbi përdorimin e pasurisë së shoqatës vendos kryesia me vendim të shumicës.
- 8.8. Vendimet me rëndësi të marra nga kryesia e shoqatës duhet të shënohen me shkrim në procesverbal dhe të nënshkruhen nga kryetari dhe procesmbajtësi.
- 8.9. Kryesia posedon të drejtën të bëjë ndryshime në statutin e shoqatës dhe ato t'i lajmërojë në Gjiqin Komunal, nëse ky vendim përkrahet nga dy të tretat e anëtarëve.

9 Arkatari

- 9.1. Të gjitha punët që kanë të bëjnë me arkën, kryhen nga arkatari.
- 9.2. Arkatari duhet të raportojë një herë në vit në mbledhjen e anëtarëve mbi gjendjen e arkës e poashtu më shpesh nëse nevojitet me kërkesë të kryesisë.
- 9.3. Arka kontrollohet edhe nga dy anëtarë të shoqatës, të zgjedhur në mbledhjen e anëtarësisë.
- 9.4. Të gjitha daljet nga arka si dhe transaksionet duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe arkatari. Nëse këta nuk janë prezentë, atëherë këtë gjë e bëjnë përfaqësuesit e tyre. Xhirollogaria (kontoja) dhe libri kursyes janë të mbyllur me një vërejtje.

10. Fuqizimi

- 10.1. Radhitja dhe njoftimi i statudit u bë në mbledhjen themeluese të shoqatës më 18.11.2016 në Eppingen.